



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA KUÇOVË

Nr. prot 459

Kuçovë, më 06/02/2024

VENDIM

Nr. 09 . Datë 30/01/2024

Bazuar ne ligjin 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e dt ___/01/2024 analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, "Për ndryshim në vendimin nr 37 dt 30.11.2023, "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave për vitin 2024", mbështetur në ligjin 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" ,neni 54,pika(dh) "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e taksave Vendore" neni 5, si dhe shkresës me nr. protokoll 851/2, dt 18.02.2023 "Për verifikim të ligjshmërisë së akteve" nga Prefekti i Qarkut Berat, për shfuqizimin e pikës 1 "Taksa vendore për biznesin e vogël", "Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël", të vendimit të Këshillit Bashkiak nr 37, dt 30.11.2023, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024", shfuqizuar kjo pike me ligjin 29/2023, "Mbi mbi tatimin mbi të ardhurat", neni 71, pika 2:

VENDOSI

1. Te miratojë shfuqizimin e pikës 1 "Taksa vendore për biznesin e vogël", "Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël"
2. Per ndjekjen dhe zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria e te Ardhurave.

Vendimi Nr. 22 u miratua me — vota pro, — vota kunder dhe — vota abstenim ,ne prezence te 22 anetareve te Keshillit Bashkiak.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU